



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 7.2 nenit 8 , 9.1 dhe 18 të Ligjit nr.04/L-212 për Financimin e Subjekteve Politike, nenit 1.2, 5 dhe 6.2 të Rregulles nr 14/2013 Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 08 korrik 2017, merr këtë :

V E N D I M

Për caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për gjashtë mujorin e II-të 2017

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton lartësinë e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike, për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike, të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit të ulëseve për atë mandat.
- II. Shuma e mjeteve për financimin e aktiviteteve të subjekteve politike nga Fondi për gjashtëmujorin e dytë të këtij viti është 2,100,000.00 € dhe ndahet si nga pika I e këtij vendimi në bazë të përfaqësimit të numrit të ulëseve të fituar në Kuvend për atë mandat, për:

AKRONIMI	EMRI I PARTISË	NUMRI I VENDEVE TE FITUARA	Shuma subjektet politike	Shuma per Grupet Parlamentare
	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS-NISMA PËR KOSOVËN-PARTIA E DREJTËSISË-LËVIZJA PËR BASHKIM-PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS-ALTERNATIVA DEMOKRATIKE E KOSOVËS-REPUBLIKANËT E KOSOVËS-PARTIA E BALLIT-PARTIA SOCIALDEMOKRATE-BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS	39	614,250.00	68,250.00
VETEVENDOSJE!	VETËVENDOSJE!	32	504,000.00	56,000.00
LDK-AKR	LIDHJA DEMOKATIKE E KOSOVES-ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	29	456,750.00	50,750.00
GISL	GRADANSKA INICIJATIVA SRPSKA LISTA	9	141,750.00	15,750.00

KDTP	KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	2	31,500.00	3,500.00
KOALICIJA VAKAT	KOALICIJA VAKAT	2	31,500.00	3,500.00
NDS	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	1	15,750.00	1,750.00
SLS	SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA	1	15,750.00	1,750.00
PDAK	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	1	15,750.00	1,750.00
PLE	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	1	15,750.00	1,750.00
JGP	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	1	15,750.00	1,750.00
PAI	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	1	15,750.00	1,750.00
PREBK	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	1	15,750.00	1,750.00
	Totali	120	1,890,000.00	210,000.00

- III. Për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet, Subjekti Politik ndanë mjete nga Fondi në pajtim me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.
- IV. Mjetet nga pika II subjekteve politike u ndahen nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për gjashtëmujorin e dytë.
- V. Borxhi i Partive Politike të shqiptuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës ndahet në dy faza, sipas alokimit periodik të mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.
- VI. Ndalesa e parë bëhet në tremujorin e tretë (TM III), ndalesa e dytë në tremujorin e katërt (TM IV) të vitit 2017.
- VII. Këto mjete të transferohen në xhirrollogarinë e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.
- VIII. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes, për zbatimin e këtij vendimi.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

